



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 28, datë 27.04.2011

PËR
MIRATIMIN E NORMËS SË INTERESIT PËR REMUNERIMIN E
REZERVËS SË DETYRUAR TË SUBJEKTEVE BANKARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 pika 3 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe të nenit 12, pika 4 të rregullores "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat" miratuar me vendim nr. 43, datë 16.07.2008, me propozim të Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Norma e interesit për rezervën e detyruar në lekë të jetë 70 (shtatëdhjetë) për qind e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të periudhës bazë.
2. Norma e interesit për rezervën e detyruar në usd të jetë 0 (zero).
3. Norma e interesit për rezervën e detyruar në euro të jetë 0 (zero).
4. Vendimi nr. 46, datë 16.07.2008 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 24.07.2011.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI